
KUSHTET E PERGJITHSHME PER SIGURIMIN E PARAVE NE UDHETIM (CIT)

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1. Kushtet e Pergjithshme per Sigurimin e Parave ne Udhetim, ketu me poshte do te quhen shkurtimisht "Kushte Sigurimi".
 - 1.1 .Shoqeria e sigurimeve "ANSIG", ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "Siguruesi"
 - 1.2 . Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i te cilit do te mbulohet sipas ketyre Kushteve te Sigurimit , ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "I Siguruar" .
 - 1.3 . Kontrata e Sigurimit te Parave ne Udhetim e lidhur midis Siguruesit dhe te Siguruarit, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "Police Sigurimi"

OBJEKTI I SIGURIMIT

2. Kartmonedha ne forme te valutave te ndryshme, perfshire edhe kartmonedhat shqiptare, deri ne kufirin e permendur ne Policen e Sigurimit.
- 2.1.Pasuria e siguruar mund te jete ne pronesi te te Siguruarit ose e mbajtur nga i Siguruari, ne çdo forme qe e ben te Siguruarin perqejges per humbjen e saj.

RREZIQET E SIGURIMIT

3. Siguruesi demshperblen te siguruarin per humbjen ose demtimin e pasurise se siguruar gjate udhetimit, nen ruajtjen e punonjesve, ose nen ruajtjen e shoqerise transportuese apo siguruese, me qellim transportin ne emer te te Siguruarit.
4. Mbulumi ne sigurim sipas ketyre Kushteve te Sigurimit do te fillojne nga momenti kur punonjesi ose shoqeria transportuese apo siguruese merr ne dorezim pasurine ne emer te te Siguruarit dhe do te perfundoje menjehere me dorezimin ne destinacion nga punonjesi ose shoqeria transportues apo siguruesi.

PERJASHTIMET

5. Ky sigurim do te mbuloje humbje apo demtim te pasurise vetem ne se shuma e kesaj humbje apo demtimi tejkalon shumen qe i Siguruari perfiton sipas:
 - 5.1. kontrates se te Siguruarit me shoqerine transportuese apo siguruese;
 - 5.2. mbulimit ne sigurim te kesaj shoqerie transportuese apo siguruese ndaj klienteve te saj;
 - 5.3. çdo lloj tjeter mbulimi ne sigurim dhe demshperblimi ne fuqi ne çdo lloj forme nga apo ne perfitim te klienteve te kesaj shoqerie transportuese apo siguruese dhe ne kete rast ky sigurim do te mbuloje vetem pjesen e shumes qe tejkalon kufijte e siperpermendur.

6. Sigurimi i Parave ne Udhetim nuk mbulon demet qe shkaktohen drejtperdrejt apo indirect prej:
 - zhdukjes misterioze;
 - mashtrimit te punonjesve;
 - grevave, kryengritjeve, trazirave dhe trubullirave civile;
 - luftes, pushtimit, invazionit, veprimeve luftareke (pavarsisht ne se eshte shpallur lufte ose jo), luftes civile, rebelimet, konflikteve ose shtetezimeve ose shkaterimeve te pasurisenga apo ne baze te urdherave te çdo qeverie ose autoritet publik ose local;
 - rrezatimi jonizues ose ndotjes radioaktive nga lende berthamore ose shperthimi i lendeve berthamore, reaktoreve berthamore apo njesive berthamore ose elementeve berthamore;

TARIFAT DHE PRIMIT TE SIGURIMIT

7. Tarifa do te caktohet ne baze te shumes se sigurimit, masave mbrojtese dhe kushteve te transportit.
Tarifa do te caktohet veçanerisht per çdo Police Sigurimi.
8. Primi i Sigurimit do te llogaritet duke shumezuar tarifen e primit te sigurimit me shumen e siguruar.
 - 8.1 Primi i sigurimit mund te paguhet teresisht ose me keste, sipas ketyre rregullave:
 - kur periudha e sigurimit eshte nen nje vit, si rregull, primi i sigurimit do te paguhet njehersh;
 - kur periudha e sigurimit eshte nje vit, primi i sigurimit mund te paguhet me keste. Ne keto reste kesti i pare eshte jo me pak se 50 % e primit vjetor dhe paguhet ne momentin e leshimit te polices, kesti i dyte jo me vone se 4 muaj nga pagimi i kestit te pare dhe kesti i fundit duhet te paguhet tre muaj perpara perfundimit te polices se sigurimit.
 - 8.2. Rregullimi perfundimtar i masas se primit do te behet me perfundimin e periudhes se sigurimit ne formen e caktuar ne Policen e Sigurimit.
 - 8.3. Primi i sigurimit paguhet me monedhen e percaktuar ne Policen e Sigurimit.
9. Ne rastin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, do te zbatohet pjese e zbritshme. Masa e pjeses se zbritshme do te caktohet ne Policen e Sigurimit, por nuk mund te kaloje 20 per qind te shumes se siguruar.

POLICA E SIGURIMIT

10. Polica e sigurimit eshte lidhur ne baze te kerkeses me shkrim nga i Siguruari. Siguruesi lehon Policen e Sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te njoftimeve dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari. Kerkesat, njotimet dhe deklarimet e bera nga i Siguruari i bashkangjiten Polices se Sigurimit.
 - 10.1. I Siguruari, me nenshkrimin e Polices se Sigurimit eshte pergjegjes per saktesine dhe vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te bera prej tij.
 - 10.2. Siguruesi ka te drejte te verifikoje vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari dhe te kryej inspektieme per saktesi te dhenash.

10.3. Polica e Sigurimit mund te perfundoje ne çdo kohe nga i Siguruari, duke i drejtuar kerkese me shkrim Siguruesit. Ne kete rast Siguruesi ka te drejte te mbaje ose te marre pjesen e primit ne perpjestim me kohe zgjatjen e Polices se Sigurimit.

11. Mospagimi ne kohe i kestit te dyte te primit te sigurimit sjell keto pasoja:

- Siguruesi ka te drejte te zgjidhe Policen e Sigurimit
- Demshperblimin e reduktuar ne masen 50 per qind per humbjet dhe demtimet e vertetuara perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim, sipas kestit te pare te primit te sigurimit.
- Kthimin nga i Siguruari te demshperblimeve te paguara, ne masen 50 per qind, per çdo humbje e demtim te vertetuar perpara perfundimitte afatit te mbulimit ne sigurim sipas kestit te pare te primit te sigurimit.

12. Periudha e sigurimit si rregull eshte 1 vit, perveç rasteve kur ne Policen e Sigurimit percaktohet ndryshe, por jo me pak se tre muaj.

12.1. Mbulimi ne sigurim fillon ne oren 24.00 te dites se fillimit te shenuar ne Policen e Sigurimit, me kusht qe te jete paguar me pare primi i sigurimit ose kesti pare i tij.

DETYSIMET

13. I siguruari detyrohet:

- te zbatoje masat dhe rregullat e sigurimit te percaktuara ne menyre specifike ne Policen e Sigurimit dhe te tregoje kujdesin e duhur ne parandalimin e demit;
- te regjistroje pasurine e siguruar sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe ne menyre te tille qe Siguruesi te mund te percaktoje me saktesi shumen e siguruar dhe masan e humbjes;

13.1. Per çdo ngjarje qe mund te jete shkak per kerkese demshperblimi, i Siguruari menjehere duhet;

- te informoje organet perkatese te rendit dhe te japi te gjithe ndihmen e nevojshme per identifikimin dhe kapjen e personave perqjegjes dhe gjetjen e pasurise se vjedhur;
- te njoftoje me shkrim Siguruesin;
- t'i jape te Siguruarit te gjithe informacionin dhe ndihmen e kerkuar.

14. Ne rast se i Siguruari deklaron kerkesen per demshperblim duke e ditur se eshte e pavertete ose mashtruese, persa i perket shumeve ose çdo elementi tjeter, mbulimi ne sigurim pushon se ekzistuari dhe te gjitha kerkesat per demshperblim anullohen.

15. Siguruesi brenda 10 diteve nga njoftimi i te Siguruarit duhet te filloje ekspertimin e demit te ndodhur.

15.1. Ne rast se i Siguruari nuk e pranon pjeserisht ose apo plotesisht aktekspertimin e Siguruesit, e njofton ate me shkrim Brenda 3 diteve nga marrja e ketij akti. Lidhur me mosmarreveshjet, te dy palet caktojne nje ekspert tjeter ose grup ekspertesh, te perbere nga perfaqsuesit e tyre ose te trete.

15.2. Eksperti duhet:

- te verifikoje dhe te sqaroje rrethanat e ngjarjes;
- te verifikoje saktesine e deklaratave dhe te percaktoje nese ne momentin e demtimit ekzistonin rrethana qe kishin ndryshuar rrezikun dhe nuk ishin komunikuar;
- te verifikoje nese i Siguruari ka plotesuar detyrimet e tij;
- te kryej vleresimin e demit, konform Kushteve te Sigurimit dhe Polices se Sigurimit.

16. Siguruesi paguan deshperblimin pasi ka marre aktekspertimin perfundimtar dhe vetem ne qofte se i eshte paraqitur kerkesa me shkrim nga i Siguruari.

17. Siguruesi paguan ose refuzon pagimin e demshperblimit brenda 30 diteve nga ajo e marrjes se kerkeses per demshperblim. Fillimi i afatit pezullohet per aq kohe sa demshperblimi nuk mund te paguhet ose percaktohet per shkak te te metave qe ka i Siguruari.

17.1. Siguruesi mund te shtyje pagesen e demshperblimit:

- per aq kohe sa nuk jane nxjerre konkluzione te qarta rrethanat e ngjarjes;
- ne qoftese eshte filluar çeshtje penale lidhur me ngjarjen ndaj te Siguruarit njerit prej punonjesve te tij deri ne perfundim te nje procedure te tille.

18. Siguruesi per gjigjet per demet qe vertetohen gjate periudhes se mbulimit ne sigurim, por shume e per gjithshme e demshperblimeve nuk mund te jete me e larte se shuma e siguruar e treguar ne Policen e Sigurimit.

19. Polica e Sigurimit e leshuar ne baze te ketyre Kushteve te Sigurimit, do te pushoje menjehere çdo lloj mbulimi ne sigurim ne rast te likujdimit (vullnetar ose te detyrueshem) te te Siguruarit, ose futjes ne marreveshje te tilla.

20. I Siguruari do te lajmeroje menjehere Siguruesin per çdo bashkim ose shkrirje me veprimtari te tjera ekonomike, ose çdo blerje, shitje te pasurise ose aksioneve, transferim, etj., qe shkaktojne ndryshim ne pronesi. Heqjen e te drejttes se veprimtarise nga Autoriteti Qeveritar apo Lokal.

21. Per çdo mosmarreveshje qe nuk zgjidhet me mirekuptim, palet do ti drejtohen Gjykates se vendit ku eshte leshuar Polica e Sigurimit.

KUSHTET E KONTRATES SE SIGURIMIT TE PARAVE NE KASAFORTE (CIS)

1. Kushtet e kontrates se sigurimit te parave ne kasaforte (CIS), ketu poshte do te quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".
 - 1.1. Shoqeria e sigurimeve "ANSIG" ketu me poshte do te quhet "Siguruesi".
 - 1.2. Personi fizik ose juridik interes i te cilit do te mbulohet sipas ketyre Kushteve te Sigurimit, ketu me poshte do te quhet shkurtimisht "I Siguruari".
 - 1.3. Kontrata per sigurimin e parave ne kasaforte, e lihur midis Siguruesit dhe te Siguruarit, ketu poshte do te quhet shkurtimisht "Polica e Sigurimit"
2. Pasuri e sigruar do te jene kartmonedhat ne forme valute te ndryshme, perfshire kartmonedhen shqiptare, deri ne kufirin e permendur ne Policen e Sigurimit.
 - 2.1. Pasuria e sigruar mund te jete ne pronesi te te Siguruarit ose e mbajtur nga i Siguruari, ne cdo forme qe e ben te Siguruarin perjegjes per humbjen e saj.
3. Siguruesi demshperblen te Siguruarin per humbjen ose demtimin e pasurise se sigruar si rrjedhoje e vjedhjes permes hyrjes dhe/ose daljes me dhune dhe/ose forcerisht nga njesia e sigruar. Pasuria mbulohet ne sigurim kur ndodhet ne kasaforte dhe/ose sportel/arke.
4. Sigurimi CIS nuk mbulun demet qe shkaktohen drejtperdrejt apo indirekt prej:
 - a. zhdukjes misterioze;
 - b. mashtrimit dhe jobeshushmerise se punonjesve;
 - 4.1. Ky sigurim nuk mbulon demet ose humbjet e shkaktuara drejtperdrejt apo indirekt, ndodhur ne saje te apo si pasoje e luftes, pushtimit, invazionit, veprimeve luftarak (pavaresisht ne se eshte shpallur lufte ose jo), luftes civile, rebelimeve, fuqive ushtarake apo pushtuese, konfiskimeve, shtetezimeve, rekuizimeve ose shkaterrimeve te pasurise nga apo ne baze te urdherave te cdo qeverie ose autoriteti publik ose lokal.
 - 4.2. Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimin/humbjen, perjegjesine apo shpenzimet e shkaktuara drejtperdrejt ose indirekt mga ose qe rrjedhin prej:
 - a. rrezatimit jonizues ose ndotjes radioaktive nga lendet berthamore ose rezeve berthamore, ose nga shperthimi i lendeve berthamore.
 - b. Lendeve radioaktive, helmuese, shperthyese ose lende te tjera te rrezikshme apo ndotese te instalimeve berthamore, reaktoreve berthamore apo njesive te tjera berthamore ose elementeve berthamore.
 - c. Çdo arme lufte qe shfrytezon zberthimin dhe/ose bashkimin berthamor apo te ngjashme me to.
5. Tarifa e primit te sigurimit do te caktohet ne baze te shumes se sigurimit, masave mbrojtese dhe kuhteve te transportit.
Tarifa do te caktohet veçanerisht per cdo police.

6. Primi i sigurimit llogaritet duke shumezuar tarifen e primit te sigurimit me shumen e siguruar.
 - 6.1. Primi i sigurimit mund te paguhet teresisht ose me keste sipas ketyr rregullave:
 - a. kur periudha e sigurimit eshte nen 1 vit, si rregull, primi i sigurimit do te paguhet njehersh;
 - b. kur periudha e sigurimit eshte 1 vit, si rregull, primi i sigurimit do te paguhet me dy keste.
 - 6.2. Ne rastin e pageses se primit te sigurimit me dy keste, data e pageses se kestit te dyte do te caktohet jo me vone se kater muaj nga data e pageses se kestit te pare, sipas percaktimit ne Policen e Sigurimit.
 - 6.3. Pagesa e primit ose kestove te tij, do te behet prane deges ose agjencise se Siguruesit ku eshte lidhur Polica e Sigurimit.
Pagesa do te quhet e kryer ne momentin e kalimit te shumes se caktuar ne llogarine bankare te Siguruesit.
 - 6.4. Primi i sigurimit paguhet me monedhen e percaktuar ne Policen e Sigurimit.
7. Ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, do te zbatohet pjesa e zbritshme. Masa e pjeses se zbritshme do te percaktohet ne Policen e Sigurimit, por nuk mund te kaloje 25 per qind te shumes se siguruar.
 - 7.1. Siguruesi nuk perjigjet per pjesen e zbritshme te percaktuar ne Policen e Sigurimit e cila do te perballohet nga i Siguruari per çdo ngjarje.
8. Polica e Sigurimit lidhet ne baze te kerkeses me shkrim te te Siguruarit. Siguruesi lehon Policen e Sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te njoftimeve dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari. Kerkesat, njoftimet dhe deklarimet e tjera te te Siguruarit i bashkangjiten Polices se Sigurimit.
 - 8.1. I Siguruari, me nenshkrimin e Polices se Sigurimi, eshte perjegjes lidhur me saktesine dhe vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te bera prej tij.
Siguruesi ka te drejte te verifikoje vertetesine e njoftimeve e deklarimeve te te Siguruarit e te kryeje inspektore per saktesine e te dhenave.
 - 8.2. Polica e Sigurimeve mund te perfundoje ne çdo kohe nga i Siguruari duke i drejtuar kerkesa me shkrim Siguruesit. Ne kete rast Siguruesi ka te drejte te mbaje ose te marre pjesen e primit ne perpjestim me kohezgjatjen e Polices se Sigurimit.
 - 8.3. Polica e Sigurimit mund te zgjidhet nga Siguruesi duke lajmeruar 30 dite me pare me shkrim te Siguruarin. Ne kete rast, Siguruesi do te mbaje ose marre pjesen e primit ne perpjestim me demshperblimin e paguar dhe kohezgjatjen e Polices se Sigurimit.
 - 8.4. Polica e Sigurimit mbetet ne fuqi per nje afat 15 ditor dhe pas dites se fillimit te detyrimit per pagimin e kestit te dyte te primit te sigurimit.
 - 8.5. Mospagimi i kestit te dyte te primit te sigurimit sjell paojat e meposhteme:
 - a. Siguruesi ka te drejte te zgjidhe Policen e Sigurimit;

- b. demhperblimin e reduktuar ne masen 50 per qind per çdo humbje e demtim te vertetuar perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim, sipas kestit te pare te primit te sigurimit;
 - c. kthimin nga i Siguruari te demshperblimeve te paguara, ne masen 50 per qind, per çdo humbje e demtim te vertetuar perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kestit te pare te primit te sigurimit.
- 8.6. Kushtet e percaktuara ne Policen e Sigurimit nuk mund te ndryshohen, perveç me shtojce qe eshte pjese e Polices nenshkruar nga punonjesi I Siguruesit. Duke pranuar Policen e Sigurimit, i Siguruari pranon se Polica perfshin te gjitha marreveshjet ekzistuese ndermjet te Siguruarit dhe Siguruesit ose agjenteve te tij, ne lidhje me kete mbulim ne sigurim.
9. Periudha e sigurimit, si rregull, eshte një vit, perveç rasteve kur ne Policen e Sigurimit percaktohet ndryshe, por jo me pak se tre muaj.
- 9.1. Sigurimi fillon nga ora 24 e dites se percaktuara ne Policen e Sigurimit, me kusht qe te jete paguar primi i sigurimit ose kesti i tij i pare.
- 9.2. I Siguruari detyrohet:
- a. te zbatoje masat e rregullat e sigurimit te percaktuara ne menyre specifike ne Policen e Sigurimit dhe te tregoje kujdesin e duhur per parandalimin e demit;
 - b. te regjistroje pasurine e siguuar sipas dispozitave ligjore ne fuqi dhe ne menyre te tille qe Siguruesi te mund te percaktoje me saktesi shumen e siguuar dhe masen e humbjes.
10. Ne rastin e ngjarjes se sigurimit, i Sigurari menjehere duhet:
- a. te informoje menjehere organet perkatese te Rendit dhe tju jape atyre te gjithe ndihmen e nevojshme per identifikimin dhe kapjen e personit/ave perqejges dhe gjetjen e pasurise se vjedhur;
 - b. te njoftoje me shkrim Siguruesin;
 - c. t'i jape Siguruesit te gjithe informacionin dhe ndihmen e kerkuar.
- 10.1. Ne rast se i Siguruari deklaron kerkesen per demshperblim duke e ditur se eshte e pavertete ose mashtruese, persa i perket shumave ose çdo elementi tjeter, mbulimi ne sigurim pushon se ekzistuari dhe te gjitha kerkesat per demshperblim anullohen.
11. Siguruesi brenda 10 diteve nga njoftimi i te Siguruarit duhet te filloje ekspertimin e demit te ndodhur.
- 11.1. Ne rastet kur i Siguruari nuk pranon pjeserisht apo plotesisht aktekspertimin e Siguruesit, e njofton ate me shkrim brenda tre diteve nga marrja e ketij akti. Lidhur me mosmarreveshjet, te dyja palet caktojne një ekspert tjeter ose një grup ekspertesh te perbere nga perfaqsues te tyre ose te trete. Eksperti ose grapi i eksperteve te lartpermendur nuk kane te drejte te riekspertojne apo te vazhdojne riekspertimin e filluar kur vertetohen demtime te tjera te pasurise se siguuar. Ne keto kushte, procedura e ekspertimit do te rifillonte sipas nenit mesiper.

- 11.2. Ekspertet duhet:
 - a. te verifikojne dhe te sqarojne rrethanat e ngjarjes;
 - b. te verifikojne saktesine e deklaratave apo përshtatimeve qe rezultojne nga aktet kontraktore dhe te percaktojne ne se ne momentin e demtimit ekzistonin rrethana qe kishin ndryshuar rezikun dhe nuk kishin komunikuar;
 - c. te verifikojne ne i Siguruari ka plotesuar detyrimet e tij;
 - d. te kryejne vleresimin e demit, konform Kushteve te Sigurimit dhe Polices se Sigurimit.
12. Per marrjen e demshperblimit, i Siguruari, i paraqet Siguruesit kerkese me shkrim.
 - 12.1. Siguruesi paguan demshperblimin pasi ka marre akt-ekspertimin perfundimtar dhe vetem ne qofte se i paraqitet kerkesa me shkrim nga i Siguruari.
 - 12.2. Siguruesi paguan ose refuzon pagimin e demshperblimit brenda 30 diteve nga ajo e marrjes se kerkeses per demshperblim.
Fillimi i afatit pezullohet per aq kohe sa demshperblimi nuk mund te paguhet ose percaktohet per shkak te te metave qe ka i Siguruari.
 - 12.3. Siguruesi mund te shtyje pagesen e demshperblimit:
 - a. per aq kohe sa ekzistojne dyshimet mbi te drejten e te Siguruarit per te marre pagesen;
 - b. ne qofte se eshte filluar çeshtja penale lidhur me ngjarjen e sigurimit ndaj te Siguruarit ose njerit prej punonjesve te tij, deri ne perfundimin e nje procedure te tillë.
 - 12.4. Siguruesi per gjigjet per demet qe vertetohen gjate periudhes se mbulimit ne sigurim, por shuma e per gjithshme e demshperblimeve nuk mund te jete me e larte se shuma e siguruar e treguar ne Policen e Sigurimit.
 - 12.5. Ky sigurim nuk do te demshperbleje deme per te cilat i Siguruari perfiton demshperblim nen kontrata te tjera. Ben perjashtim pjesa e demit qe tejkalon shumen qe do te ishte mbuluar nen kontratat e tjera ne rastin kur Polica e percaktuar nga keto Kushte Sigurimi te mos ishte ne fuqi.
 - 12.6. Ne rast pagese demi sipas kesaj Police, Siguruesi do te kete te drejte te perfitoje te drejten e te Siguruarit per te kerkuar kthimin e te drejtave pasurore ose çdo te drejte legale ndaj cdo personi ose organizate. I Siguruari do te veproje me te gjitha menyrat per te paragjykuar keto te drejta.
13. Polica e Sigurimit, leshuar ne baze te ketyre Kushteve te Sigurimit, do te pushoje menjehere çdo lloj mbulimi ne sigurim ne rast te likujdimit (vullnetar ose te detyrueshem) te te Siguruarit, ose futjes ne marreveshje te tillë.
 - 13.1. I Siguruari do te lajmeroje menjehere Siguruesin per:
 - a. çdo bashkim ose shkrirje me veprimitari te tjera ekonomike ose çdo blerje, dhenie, transferim, lenje peng apo shitje te pasurive apo aksioneve qe shkaktojne



- ndryshime ne pronesi, ose kontrollin financier, ose tjeter te veprimtarise ekonomike;
- b. hedjen e kontrollit te te Siguruarit mbi veprimtarine ekonomike nga çdo Qeveri apo zyrtar i caktuar nga çdo Qeveri apo Autoritet Lokal.
- 13.2. Kusht per vazhdimin e mbulimit ne sigurim eshte qe i Siguruari t'i jape menjehere Siguruesit informacionin qe Siguruesi do te kerkoste dhe i Siguruari te paguaj primin shtese, siç mund te kerkoste Siguruesi si rrjedhoje e ketij ndyshimi.
14. Per çdo mosmarreveshje qe nuk zgjidhet me mirekuptim, palet do t'i drejtohen Gjykates se vendit ku eshte leshuar Polica e Sigurimit.

